



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 99 Prot

Tiranë, më 05.07, 2010

VENDIM Nr. 10 dt. 01.07.2010

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, “Për Trashëgiminë Kulturore”, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 01.07.2010:

VENDOSI:

Sipas pikave të rendit të ditës:

Lidhur me: Diskutimin mbi problematikën e gjëndjes ekzistuese të kishave në rrethe të ndryshme në Shqipëri.

1. Hartimin brenda 4 muajve nga IMK i tërë projekteve për kishat e rrezikuara.
2. Hartimin brenda 2 javëve të një pakete për hapësirat promociionale që M.T.K.R.S ofron, për gjetjen e një fondi emergjence rreth 45-50.000.000 lekësh.
3. Në muajin shtator ngarkohet Drejtoria e Turizmit dhe Trashëgimisë së Kulturës Kombëtare dhe Drejtoria e Kulturës pranë MTKRS për të raportuar në KKR mbi ecurinë e gjetjes së fondit.
4. Në muajin shtator ngarkohet IMK të raportojë në KKR mbi ecurinë e projekteve të kishave në Shqipëri.

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R
FERDINAND XHAFERRAJ

SEKRETAR I KKR
AKADEMIK. APOLLON BAÇE